

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

**Auditim i avancuar dhe  
siguria  
(zgjidhjet)**

**P10**

Data 26/01/2019

## Detyra 1

Auditimi i pasqyrave financiare te Dua Shpk për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017 është duke përfunduar dhe pritet që raporti i auditimit të nënshkruhet javën e ardhshme. Dua Shpk prodhon pjesë për industrinë automobilistike.

Ju jeni duke kryer rishikimin e kontrollit të cilësisë të këtij angazhimi. Dua Shpk është entitet i listuar në bursë dhe klient i ri i firmës tuaj. Pasqyrat financiare draft të kompanisë paraqesin të hyra prej €8.7 milion, pasuri prej €15.2 milion dhe fitim para tatimit prej €1.8 milion.

Ju i keni identifikuar çështjet në vijim për rishikim:

**(i)** Qasja e planifikuar në auditimin e llogarive të pagueshme ishte që të mbështeteni në kontrollat mbi procesin e blerjeve dhe kështu të mbahen në minimum testet thelbësore. Gjatë testimit të kontrollove mbi llogaritë e pagueshme, nga një mostër e rastësishme, ekipi i auditimit ka identifikuar tre urdhër blerje të cila nuk ishin autorizuar nga menaxheri i prokurimit. Gjatë rishikimit të dokumenteve mbështetëse, ekipi i auditimit ka ardhur në përfundim se zërat e kontrolluar janë shpenzime legjitime të biznesit prandaj ka përfunduar se nuk ka nevojë të kryhen procedura shtesë të auditimit. (6 pikë)

**(ii)** Pas rishikimit të transaksioneve nga paraja e imët, asistenti i auditimit ka identifikuar se arkëtari kishte paguar për shpenzimet e taksit për nevoja personale në vlerë prej €175. Pas diskutimit me asistentin e auditimit, ju jeni siguruar se ai nuk e kishte raportuar këtë pasi që ka konsideruar se shuma është jomateriale. Asistenti i auditimit gjithashtu ka komentuar se arkëtari është vëllau i tij dhe ai nuk deshë ti shkaktonte probleme atij. (6 pikë)

**(iii)** Testimi i prerjes së të hyrave ka identifikuar dy fletëdërgesa me datën 4 janar 2018 për artikujt që i janë dërguar Rita SH.A në vlerë të prej €17,880 (të dy dërgesat) të cilat ishin njohur si të hyra të vitit deri me 31 dhjetor 2017. Kontabilisti i Dua Shpk kishte shpjeguar se Rita SHA nuk porositi në baza të rregullta nga Dua Shpk. Pasi që nuk ka një histori të rregullt të pagesave dhe për të minimizuar periudhën e mbledhjes së llogarive të arkëtueshme nga ky konsumator, ishte lëshuar fatura e shitjes në ditën e njëjtë kur është pranuar fletëporosia nga konsumatori. Koha mesatare në mes të pranimit të një fletëporosie dhe dërgimit të mallit është rreth dy javë. Në letrat e punës së auditimit ishte konkluduar se nuk ka nevojë për hetim të mëtutjeshëm. (7 pikë)

**(iv)** Drejtori financiar, Arushani, nuk kishte përfunduar llogaritjen e tatimeve për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017. Ai kishte kërkuar nga asistenti i auditimit të llogaris tatimet e pagueshme për vitin pasi që asistenti i auditimit sapo ishte kualifikuar si kontabilist i certifikuar dhe se ishte më i azhurnuar me ndryshimet e fundit në legjislacionin tatimor. (6 pikë)

### **Kërkohet:**

Vlerësoni çështjet e kontrollit të cilësisë dhe implikimet në përfundimin e auditimit përfshirë çfardo veprimi të mëtutjeshëm që duhet të merret nga firma juaj e auditimit.

Përgjigja juaj duhet të përfshijë çështjet që duhet t'i komunikohen menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen lidhur me auditimin e Dua Shpk.

**(Total = 25 pikë)**

## Zgjidhja

### (i) Testimi i kontrolleve mbi të pagueshmet

Mungesa e dëshmive për autorizim nga meanxheri i prokurimit lidhur me tre urdhërblerja paraqet përjashtim nga operimi me efektivitet i kontrolleve të brendshme mbi të cilat auditori mbështetet. Rishikimi i dokumenteve mbështetëse dhe konkluzioni që zërat ishin blerje legjitime të biznesit nuk e zgjidh përjashtimin nga operimi efektiv i KB. Ekziston rreziku se mund të ketë përjashtime tjera dhe blerje të pautorizuara të cilat mund të mos jenë për qëllime të biznesit. Procedurat e auditimit në këtë rast janë të pamjaftueshme. Asistenti i auditimit duhet të kishte raportuar këtë çështje te menaxheri dhe partneri për të vendosur më tutje për punën e auditimit në vijim.

Para përfundimit të auditimit, ekipi duhet të vlerësojë rëndësinë e mangësive në kontrollin e brendshëm dhe të konsideroj rritjen e mostrës dhe zgjerimin e testeve të auditimit. Nëse edhe testet e zgjeruara të kontrollit tregojnë për mangësi në kontrolle, atëherë duhet konsideruar nëse të mbështetemi në ato kontrolle dhe cilat procedura thelbësore të zbatohet.

Në pajtueshmëri me SNA 260 Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen, auditori duhet të komunikojë këtë mangësi te ata.

### (ii) Fondi i parasë së imët

Pagesa për shepnzimet personale të taksit është transaksion mashtrues nga paraja e imët dhe duhet të rishikohet nga ky këndvështrim. SNA 240 Përgjegjësitë e auditorit lidhur me mashtrimin në auditimin e pasqyrave financiare thekson se përgjegjësia priamre për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimeve i takon personave të ngarkuar me qeverisjen dhe menaxhmentit. Ekzistenca e mashtrimit tregon për kontroll të dobët të brendshëm. Auditori është përgjegjës për përfundimin e sigurisë së arsyeshme se pasqyrat financiare janë të pastra nga anomalitë materiale, qoftë nga mashtrimet ose gabimet. Shuma prej €175 është jomateriale por auditori duhet të verifikoj nëse ka raste tjera. Marrëdhënia e asistentit të auditorit me arkëtarin paraqet kërcënim të pavarësisë nga njohja/familjariteti dhe dështimi për të lajmëruar marrëdhënien mund të paraqet mungesë të integritetit profesional nga asistenti i auditimit. Në pajtueshmëri me SNA 220 Kontrolli i cilësisë në auditimin e pasqyrave financiare, partneri i angazhimit ka përgjegjësi të monitoroj kërkesat etike gjatë gjithë procesit të auditimit.

Nëse auditori arrin në përfundim se mashtrimi me paranë e imët e rrit vlerësimin e përgjithshëm për mashtrim dhe rrezik të kontrollit, kjo çështje duhet të komunikohet menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen.

### (iii) Testimi i prerjes për të hyrat

SNRF 15 Të hryat nga kontratat me konsumatorët kërkon që entiteti një njeh të hyrat nëse enteti përmbush obligimin për performancën duke transferuar mallrat ose shërbimet e premtuara te konsumatori. Një apsuri transferohet atëherë kur konsumatori e merr kontrollin mbi atë pasuri. Duke u bazuar në këtë, të hyrat janë njohur shumë herët prandaj si rezultat i kësaj të hyrat, të arkëtueshmet dhe fitimi janë mbivlerësuar.

Gabimi në vete është jomaterial pasi që përfaqëson 0.2% të të hyrave. Gabimi duhet të ekstrapolohet bazuar në indeksin e gabimeve tjera të identifikuar dhe nivelin e shitjes te ky konsumator për të vlerësuar nëse është anomali materiale. Auditori duhet të bisedoj me menaxhmentin për tu siguruar se ky faturim është rast i izoluar dhe më tutje të rishikoj edhe konsumatorët tjerë nëse ka pasur raste të ngajshme.

Të gjitha anomalitë duhet të komunikohen menaxhmentit dhe të kërkohet të korrigjohen nga entiteti.

SNA 260 kërkon që auditori të komunikojë te PNMQ qëndrimet e tij/saj për zbatimin e standardeve të kontabilitetit.

**(iv) Këshilla tatimore**

Ashtu siç është theksuar në pikë (ii), auditori kërkohe të monitoroj kërkesat etike gjatë tërë auditimit.

Ofrimi i asistencës në llogaritje e tatimeve të pagueshme paraqet kërcënim të vetërishkimi. Ky rrezik rritet edhe më tutje pasi që klienti është i listuar në bursë dhe kjo është e ndaluar nga Kodi i Etikës i IESBA.

Sipas SNA 260, auditori duhet të raportoj mungesën e aftësisë së drejtorit dhe kërkesë për trajnim të stafit të punësuar të kompanisë dhe procedurat e punësimit. Auditori gjithashtu duhet të raportoj çështjen e pavarësisë lidhur me kërkesën e drejtorit për ti ndihmuar në përgatitje e llogaritjeve të tatimi.

## Detyra 2

(a) Ju jeni menaxher i auditimit në Ponto-Audit. Ju jeni përgjegjës për auditimin e klientit Liberta Shpk, kompani e cila gjeneron për afërsisht 10% të të hyrave të firmës tuaj të auditimit. Drejtori financiar i Liberta ju ka kontaktuar që të ofroni informata lidhur me një kompani tjetër, Setra Shpk, e cila është duke kërkuar auditor. Ekstrakti nga emaili që ju ka dërguar drejtori financiar është paraqitur mëposhtë:

*'Njëri nga shokët e mi, Gëzimi, është drejtor menaxhues i Setra Shpk, një kompani e vogël e cila është duke synuar të rritet në vitet e ardhshme. E di që Gëzimi i është drejtuar bankës që ti ofroj financim prej €6 milion për të financuar zgjerimin e kompanisë. Në mënyrë që të mbështes aplikacionin për kredi Gëzimi duhet të angazhoj një firmë që të ofroj këshilla tatimore dhe të përgatis deklaratat tatimore për kompaninë dhe Gëzimin për tu dorëzuar në Adminsitratën Tatimore. I kam thënë Gëzimit të të kontaktoj dhe shpresoj se Ponto-Audit do të jetë në gjendje të ofroj këto shërbime për Gëzimin me një tarifë më të ulët. Nëse tarifa që propozoni është shumë e lartë dhe e papranueshme për Gëzimin, atëherë do t'i rekomandoj Gëzimit të kontaktoj firmën tjetër të auditimit Guri-Audit dhe gjithashtu do të konsideroja edhe vet të angazhoja Guri-Audit të auditoj pasqyrat e Liberta Shpk.'*

Guri-Audit është një firmë e licencuar e auditimit që operon në qytetin e njëjtë me Ponto-Audit. Ju keni hulumtuar pak dhe keni vënë re se kompania Setra është kompani e vogël dhe nuk kërkohet të auditohet sipas ligjit. Kompania zotërohet dhe menaxhohet nga Gëzimi i cili është pronar me 90% të aksioneve. Gëzimi po ashtu është pronar edhe në tre kompani tjera. Në një artikull gazete të para disa viteve thuhej se një kompani e Gëzimit ishte dënuar nga gjykata për shkak të shkeljes së ligjit të punës pasi që kishte shfrytëzuar parat e skemës pensionale për të hapur një biznes të ri jasht vendit në të cilin kishte vendosur drejtor djalin e tij.

### **Kërkohet:**

Lidhur me pranimin e mundshëm të angazhimit nga Ponto-Audit të Setra si klient i firmës:

- (i) Shpjegoni çështjet etike dhe çështjet tjera që duhet të konsiderohen; dhe
- (ii) Shpjegoni rëndësinë e ekzmiminimit të klientit (njihe klientin tuaj) para pranimin të angazhimit dhe tregoni çfarë informata duhet të merrni për këtë qëllim. (16 pikë)

(b) Point-Audit është pajtuar të kryej një angazhim të sigurisë për Liberta; ky angazhim do të jetë rishikim i informatave financiare të ardhshme i cili nevojitet për të mbështetur aplikacionin për overdraft nga banka. Viti financiar i Setra ka përfunduar me 30 shtator 2017 dhe opinionin e auditorit për këto pasqyra ishte pa rezervë. Auditori përgjegjës për etikën në firmën Ponto-Audit është pajtuar se çfardo kërcënim i ndaj pavarësisë për Liberta do të zvogëlohet në nivel të pranueshëm përmes angazhimit të një ekipi të veçantë nga ekipi i auditimit. Parashikimi i fitimit operativ për dy vitet deri me 31 mars 2020 i përgatitur nga kontabilistët e Liberta është paraqitur më poshtë, së bashku me disa shënime shoqëruese:

	Shënimi	Gjashtëmuji deri me 30 shtator 2018 €'000	Gjashtëmuji deri me 31 mars 2019 €'000	Gjashtëmuji deri me 30 shtator 2019 €'000	Gjashtëmuji deri me 31 mars 2020 €'000
Të hyrat	1	12,800	16,900	13,700	18,900
Fitimi bruto %		34%	45%	36%	46%
<b>Kosto operative</b>					
Personeli		(2,800)	(2,900)	(2,800)	(2,900)
Kosto e dizajnit	2	(1,200)	(1,200)	(1,250)	(1,250)
Marketingu		(900)	(1,000)	(1,100)	(1,100)
Intersi në mbitërheqje	3	(25)	(10)	-	-
Shpenzimet tjera	4	(3,840)	(5,070)	(4,110)	(5,670)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>4,035</b>	<b>6,720</b>	<b>4,440</b>	<b>7,980</b>

**Shënime:**

1. Liberta Shpk është prodhues i kartolinave dhe dhuratave të ngjashme të cilat kanë treg sezonal.
2. Kosto e dizajnit është kryesisht kosto e pagave për personelin e punësuar në ekipin e dizajnit dhe këto kosto kanë të bëjnë me dizajnin dhe zhvillimin e produkteve të reja.
3. Liberta është pajtuar me bankën që të mbyll overdraftin me 1 shtator 2019 dhe menaxhmenti është i sigurt se pas asaj date kompania nuk do të ketë nevojë për overdraft.
4. Totali i 'Shpenzimeve tjera' është llogaritur bazuar në 30% të të hyrave të parashikuara për periudhën gjashtë mujore.

**Kërkohet:**

Rekomandoni procedurat e ekzaminimit të cilat duhet të përdoren në rishikimin e parashikimit të fitimit.  
(9 pikë)

**(Total = 25 pikë)**

## Zgjidhja

(i) Çështjet që duhet të konsiderohen:

- Kompeteve për të kryer angazhimin dhe nëse firma ka aftësi përfshirë kohë dhe burime për të kryer punën.
- Pajtueshmëria me kërkesat etike, dhe
- Integriteti i klientit dhe nëse ka faktorë që rezultojnë në konkludimin se menaxhmenti ka mungesë të integritetit.

### Kompetenca dhe burimet

Duket se firma e auditimit ka kompetencën për të kryer angazhimin. Pasi që shërbimi i kërkaur është rishikim i pasqyrave financiare ndërsa firma është firmë e licensuar për auditim, nuk ka dyshim se mund ta kryej rishikimin.

Mirëpo, presioni për të kryer auditimin me tarifë më të ulët mund të ndikojë në aftësinë e firmës së auditimit të kryej angazhimin me cilësi të lartë për shkak të burimeve të pamjaftueshme që mund të punësohen në këtë angazhim. SNKC 1 thekson se në rastet kur klientët në mënyrë agresive mundohen të mbajnë tarifa të ulëta të auditimit, ky është tregues për mungesë të integritetit nga klienti.

### Çështjet etike

E para, duket se kompania është duke bërë presion që firma e auditimit të pranoj angazhimin. Pasi që klienti është i madh dhe përfaqëson 10% të të hyrave të firmës së auditimit, ekziston një kërcënim i frikësimit për të shkuar te firma tjetër e auditimit nëse ajo nuk ofron tarifa më të ulëta. Kjo po ashtu mund të konsiderohet si kërcënim i interesit personal pasi që firma e auditimit ka interes financiar të mbajë klientin.

Një çështje tjetër etike paraqitet nga sugjerimi që firma e auditimit duhet të ofroj këshilla tatimore për kompaninë Setra. Kjo mund të paraqes kërcënim të vetërishikimit pasi që shifrat e njëjta duhet të verifikohen si pjesë e angazhimit për rishikim.

Ofrimi i këshillave tatimore mund të konsiderohet se auditori është duke vepruar në emër të menaxhmentit që në vete përbën kërcënim të pavarësisë ku ofrohen shërbime tjera të sigurisë, në rastin e mësipërm rishikimi i pasqyrave financiare.

Auditori duhet të konsideroj nëse ka masa mbrojtëse të mjaftueshme për të reduktuar kërcënimet etike në nivel të pranueshëm, psh përmes përdorimit të ekipeve të veçanta në angazhimet e ndryshme. Nëse masat mbrojtëse nuk e zvogëlojnë kërcënimin, atëherë auditorët duhet të refuzojnë angazhimin për të ofruar shërbime shtesë të rishikimit.

### Integriteti i klientit

Përgatitja e tatimeve për Gëzimin nuk është çështje etike por më shumë ka të bëjë me integritetin e tij.

Integriteti i Gëzimit duhet të vlerësohet me kujdes. Nuk ka asgjë të keqe se ai ka interesa edhe në kompani tjera, por çështja është rreth shkëljes së ligjit të punës që kishte ndodhur më herët. Kjo tregon se Gëzimi ka një reputacion të dyshimt dhe se ka gjasa se ishte përfshirë në aktivitet kriminal, varësisht nga ligjet që ishin shkelur dhe nga serioziteti i mospajtueshmërisë. Informata vjen nga një artikull në gazetë prandaj duhet të bëhen hetime të mëtutjeshme.

Fakti se biznesi i tij gjendet në një vend të huaj mund të çoj në dyshime se jo gjithçka është e pastër dhe duhet pasur kujdes për rrezikun e pastrimit të parasë.

Auditorët duhet të konsiderojnë informatat me kujdes dhe të dokumentojnë procedurat e pranimit të klientit.

**(ii)**

Njihe klientin, kërkohet si procedurë që është pjesë e rregullores kundër pastrimit të parave dhe gjithashtu është pjesë e procedurave të pranimit të klientit të ri. Kjo ka të bëjë me përfitim të informatave për klientin potencial për të verifikuar identitetin duke iu referuar burimeve të pavarura. Kjo është pjesë thelbësore e vlerësimit të rrezikut në fazën e pranimit të klientit si dhe njohjes së biznesit të klientit por gjithashtu edhe të verifikimit të burimeve të financimit të klientit. Si pjesë e kësaj procedure, auditorët duhet të:

- Identifikojnë klientin dhe verifikojnë identitetin e tij përmes informatave të pavarura
- Konfirmojnë identitetin e aksionarëve, përfshirë anëtarët e familjes të cilë së bashku zotërojnë 90% të kompanisë dhe aksionarëve tjerë me 10% të mbetura.
- Identifikojnë përfituesit primar të klientit. Kush është prapa individëve.
- Kuptimi i natyrës së biznesit dhe financimit.

Bizneset gjithashtu duhet të monitorojnë në baza të vazhdueshme transaksione të mëdha dhe të pazakonta.

Informatat që duhet të përftohen në këtë rast janë:

- Konfirmimi i identitetit të Gëzimit, dëshmi fotografike, psh Pasaporta.
- Në rastin e kompanisë Setra, certifikatën e regjistrimit, statusin në regjistrin e bizneseve
- Identitetin e kompanive tjera të kontrolluara nga Gëzimi për të konfirmuar ekzistencën e tyre dhe natyrën e marrëdhënieve me Setra.
- Pasqyrat financiare për të kuptuar natyrën e biznesit dhe për të identifikuar burimet kryesore të hyrave dhe nëse ka transaksione domethënëse në mes të kompanive.
- Identifikimi i burimeve të financimit të kompanisë, psh me kredi bankare ose ofrues tjerë të financimit.
- Informata shtesë lidhur me shkeljen e ligjit të punës.

**(b) Procedurat e ekzaminimit**

Procedurat e përgjithshme

- Pyetje për identitetin e përgatitësit të parashikimit të parasë për të vlerësuar kompetencën sidomos pasi që kosto e interesit është përfshirë si pjesë e fitimit operativ – që është gabim.
- Përfitimi i njohurisë për procedurat dhe kontrollet që janë përdorur në përgatitjen e parashikimit, psh a është aprovuar ky parashikim nga ndonjë anëtarë senior i ekipit të kontabilitetit të kompanisë.
- Konfirmimi se politikat e zbatuara të kontabilitetit janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme, psh kostot e dizajnit shpenzohen e nuk kapitalizohen si kosto e zhvillimit.
- Konfirmimi se supozimet që janë bërë në përgatitjen e parashikimit janë në pajtueshmëri me njohurinë tonë të biznesit, psh sezonaliteti i shitjeve, etj.
- Rillogarita e parashikimit nëse matematikisht është e saktë.

Procedurat specifike:

- Pyetje nëse ka ndonjë parashikim më të detajuar dhe kërkesa për pasqyrat financiare.
  - Rillogaritja e fitimit bruto pasi që të kemi përfutuar shifrat mbështetëse.
- Krahasimi i këtij fitimi bruto me fitimin bruto të pasqyrave financiare të audituara nga viti i mëparshëm.
- Kryerja e procedurave analitike për të konfirmuar se kostot e paraqitura janë në pajtueshmëri me pritjet nga shifrat që kemi pranuar më herët.
  - Vlerësimi nëse ka ndonjë kategori e shpenzimeve që nuk është përfshirë në parashikim.
  - Për të hyrat, pse është një rritje aq e madhe prej 11.8% nga gjashtë mujori tjetër, konsideroni nëse parashikimi është shumë optimist, psh duke verifikuar edhe shpenzimet përkatëse të rritura.
  - Krahasimi i të hyrave në parashikim me të hyrat nga pasqyrat e audituara të vitit të kaluar.
- Hetoni çfardo trendi të pazakont përmes diskutimit me menaxhmentin.



- Rishikimi i planeve të marketingut dhe diskutimi me drejtorin e shitjes për të përcaktuar arsyen për rritjen domethënëse të të hyrave të parashikuara.
- Rishikimi i kostove të dizajnit pasi që duket se janë mjaft statike me një rritje të vogël. Pyetni menaxhmentin a mund të ketë rritje të të hyrave me një rritje aq të vogël të kostove të dizajnit.
- Konfirmoni kostot me dokumentet mbështetëse.
- Vlerësoni nëse overdraft ka mundësi të paguhet deri në shtator 2019 psh duke rishikuar parashikimin e rrjedhës së parasë
- Diskutoni me menaxhmentin arsyen e përdorimit të 30% të të hyrave si bazë për përcaktimin e shpenzimeve tjera.

### Detyra 3

Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e Farm-Tek Shpk, një kompani që merret me hulumtime farmaceutike. Ju jeni duke planifikuar procedurat thelbësore që do të përdoren në auditimin e pasurive të patrupëzuara dhe shpenzimeve operative.

Ekstraktet relevante nga pasqyrat financiare janë siç vijon:

	30 Dhjetor 2017 (draft)	30 Dhjetor 2016
<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>	€000	€000
Pasuritë e patrupëzuara: Kosto e zhvillimit		
Kosto	2,750	2,000
Amortizimi i akumuluar	(1,450)	(850)
	1,300	1,150
Gjithsej pasuri	18,500	15,000
<b>Pasqyra e të ardhurave</b>		
Te hyrat	4,500	3,800
Shpenzimet operative përfshijnë:		
Kosto e hulumtimit	160	200
Amortizimi i kostove të zhvillimit	600	450
Shpenzimet e pagave	380	400
Fitimi para tatimit	1,800	1,530

Në vijim janë pjesët nga shënimet e draft pasqyrave financiare:

*'Shpenzimet e zhvillimit të produkteve kapitalizohen si pasuri të patrupëzuara prej momentit kur është e mundshme se do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga produktet e përfunduara. Çfardo kosto e zhvillimit e cila nuk i plotëson kriteret e mësipërme njihet si shpenzim i hulumtimit.*

*Aktualisht janë dy produkte në fazën e zhvillimit: Medex dhe Florex, barëra që përdoren në zvogëlimin e simptomave të gripit.*

*Amortizimi i kostove të zhvillimit fillon me prodhimin komercial të produkteve. Periudha e amortizimit është jetëgjatësia e parashikuar e produktit. Aktualisht dy produkte janë duke u amortizuar në periudhat vijuese:*

- 1. Arum Ex pesë vite*
- 2. Blingo Ex tre vite.'*

Gjatë fazës fillestare të planifikimit të auditimit, seniori i auditimit kishte shënuar:

*'Bio-rex është konkurrenti kryesor i klientit tonë. Duket se Bio-rex është duke zhvilluar një produkt rival të Florex.*

*Ky produkt rival pritet të lansohet në korrik të vitit 2018, gjashtë muaj para lansimit të pritit të Florex.'*

Farm-Tek ka vendosur të kontraktojë funksionin e pagave që nga korriku 2017. Ky shërbim ofrohet nga ProPagat, një kompani e vogël. Të gjitha të dhënat kontabël lidhur me pagat mbahen nga ProPagat. Në vitet e mëparshme auditimi i shpenzimeve të pagave është kryer duke përdorur qasje të bazuar në sisteme (të kontrolleve) me procedura të kufizuara thelbësore.

**Kërkohet:**

- (a) Përkufizoni 'kontraktimin nga jashtë' (outsourcing) dhe shpjegoni çështjet që duhet konsideruar gjatë planifikimit të auditimit të shpenzimeve të pagave. (10 pikë)
- (b) (i) Shpjegoni çështjet që duhet të konsideroni për të përcaktar nëse kostot e zhvillimit janë njohur si duhet; dhe (6 pikë)
- (ii) Përshkruani dëshmitë që do të kërkoni për të mbështetur pohimin se kostot e zhvillimit janë teknikisht të mundshme (fizibiliteti teknik). (4 pikë)
- (c) Përshkruani procedurat e auditimit që duhet të kryeni për të përcaktuar vlefshmërinë e normës së zhvlerësimit prej pesë viteve që përdoret në amortizimin e kostove të zhvillimit për produktit Arum Ex. (5 pikë)

**(Total = 25 pikë)**

## Zgjidhja

**(a)** Kontraktimi nga jasht është rasti kur një organizatë e jashtme (po ashtu e njohur si organizatë për shërbime) përdoret për të kryer funksione të cilat përndryshe do të kryheshin nga vetë entiteti. Organizatat për shërbime zakonisht operojnë në dy mënyra:

- Organizata i mban në tërësi funksionet e kontraktuara dhe merret me të gjitha aspektet e funksionit përfshirë përcaktimin e regjistrave të kontabilitetit, mbajtjen e atij sistemi dhe inicimin e transaksioneve. Në këtë rast të dhënat ruhen te organizata.
- Organizata i ekzekuton transaksionet vetëm pas kërkesës së entitetit ose vepron si kujdestar i pasurive. Në këtë rast të dhënat ruhen nga vet entiteti.

Çështjet që duhet konsideruar në planifikimin e auditimit të pagave:

### Materialiteti

Shpenzimet e pagave janë material me 8.4% të të hyrave të 2017 dhe 10.5 % të të hyrave të 2016. Përveç kësaj shpenzimet e pagave janë shpalosur ndaras nga shpenzimet tjera operative si dhe një pjesë e kostove të zhvillimit përmbajnë në vetë shpenzime të pagave.

### Qasja në informata

Çështja kyçe është se auditorët kanë kontratë me entitetin e jo me kontratorin ProPaga. Kjo do të thotë se auditorët nuk kanë të drejtë direkte për tu qasur në të dhënat e ProPaga. Është me rëndësi që auditorët të kenë qasje në të dhënat për pagat vetëm.

### Rreziku i kontrollit

Në vitet e mëparshme auditimi i pagave ishte bazuar në sisteme (mbeshtetje në kontrolle) që do të thotë se ka pasur kontrolle të mira. Por pasi që tani ky funksion është nënkontraktuar, auditori duhet të vlerësoj përsëri kontrollet e brendshme që operohen nga ProPaga. Duhet të konsiderohen çështjet në vijim:

- Çfarë procedura të kontrollit të cilësisë ka Brenda ProPaga
- Shkallën e monitoritmi nga kompania te ProPaga, psh rishikimi mujor i regjistrave të pagave.
- Shpeshtësinë e gabimeve në të dhënat e pagave që nga momenti i nënkontraktimit të funksionit të pagave.

Pasi që shpenzimet e pagave janë materiale, sistemi i kontabilitetit të ProPaga duhet të dokumentohet në tërësi dhe të testohen kontrollet për të përcaktuar shkallën e mbështetjes në ato kontrolle.

### Ekzistenca e regjistrave të pavarur

Nëse Farm-tek nuk mban kopje rezerv të regjistrave atëherë të dhënat për pagat janë të ruajtura vetëm te ProPaga. Atëherë kemi rrezik se nuk ka kontrollim të pavarur nga kompania të punës së kryer nga ProPaga.

### Pajtueshmëria

Duhet të sigurohemi se të dhënat kontabël mbahen si duhet nga organizata për shërbime. Të dhënat për pagat duhet të jenë në pajtueshmëri me ligjet tatimore dhe të tjera dhe të cilat mund të kenë kontrolle tatimore periodike.

### Inicimi i transaksioneve

Një çështje thelbësore është fakti nëse pagesat ndaj punonjësve dhe ndalesat për aspektet tatimore inicohen nga ProPaga apo vetë entiteti. Nëse inicohen nga ProPaga atëherë auditori duhet të kryej procedura thelbësore në regjistrat e ProPaga.

## **(b) (i) Materialiteti**

Vlera neto në libra e kostove të zhvillimit paraqet 7% të pasurive totale (2016 – 7.7%) prandaj është material.

Kosto e kapitalizuar gjatë vitit është €750,000. Nëse këto kosto nuk janë kapitalizuar si duhet, atëherë kosto duhej të ishte shpenzuar. Kjo do të zvogëlonte fitimin me €750,000, që përfaqëson 42% të fitimit të vitit. Kjo është shumë material. Prandaj është me rëndësi të grumbullohen dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme lidhur me njohjen e kostove të zhvillimit si pasuri. Në 2017 janë kapitalizuar €750,000 dhe nëse i shtohen €160,000 të kostove të shpenzuara të hulumtimit,

nënkutpohet se kanë ndodhur €910,000 që përfaqëson 20.2% të të hyrave, që përsëri është shumë material.

Standardi i kontabilitetit

Kostot e zhvillimit duhet të kapitalizohen si pasuri të patrupëzuara në pajtueshmëri me SNK 38 nëse:

- Qëllimi për të përfunduar pasurinë e patrupëzuar për ta përdorur ose shitur
- Fizibiliteti teknik dhe aftësia për ta shitur
- Aftësia për të gjeneruar përfitime të ardhshme ekonomike
- Disponueshmëria e burimeve teknike, financiar dhe të tjera për ta përfunduar atë
- Aftësia për të matur shpenzimet që i atribuohen pasurisë së patrupëzuar.

Kostot e hulumtimit duhet të shpenzohen dhe gjithashtu kostot e zhvillimit nëse nuk plotësojnë kriteret e mësipërme.

Ka rrezik se jo të gjitha kriteret janë përmbushur për shkak të natyrës subjektive të vet zhvillimit:

- Zhvillimet farmaceutike janë industry shumë e rregulluara. Nëse qeveria nuk e licenson produktin, ai nuk mund të shitet prandaj nuk ka ndonjë përfitim ekonomik që mund të pranohet në të ardhmen.
- Vlefshmërinë komerciale duhet të justifikoj hulumtimi i tregut. Lansimi i produktit rival nga një kompani tjetër do të thotë se pjesa e tregut e parashikuar mund të jetë shumë më e vogël. Kjo do të thotë se produkti mund të mos gjeneroj të hyrat e parashikuara ose të mos gjeneroj fare të hyra.

**(ii) Dëshmitë:**

- Rishikimi i rezultateve të testeve shkencore të kryera në produkte.
- Diskutimi i këtyre rezultateve nëse janë të dëmshme për shëndetin.
- A ka licenca të duhura nga organet rregullatore
- Krahasimi i kostove të pritura me aktualet.
- Rishikimi i procesverbalëve të takimeve të bordit që lidhen me diskutimet e zhvillimit të produkteve të reja.

**(c) Procedurat e auditimit:**

- Përftoni dokumentet lidhur me hulumtimin e tregut. Rishikoni dhe sigurohuni se hulumtimi i tregut mbështet jetëgjatësinë prej 5 vitesh.
- Rishikoni shitjet aktuale që nga lansimi i produktit dhe krahasoni me shitjet e parashikuara sipas hulumtimit të tregut.
- Vlerësoni supozimet e bëra në hulumtimin e tregut dhe konsideroni nëse ato pëpruthen me njohurinë e auditorit për biznesin.
- Diskutoni trendet e shitjes me drejtorët e shitjes/marketingut dhe sigurohuni se janë në pajtueshmëri me pritjet e menaxhmentit.
- Përftoni buxhetet e marketingut/reklamës dhe sigurohuni se ka sa shpenzime të mjaftueshme për të mbështetur shitjen e produktit.

#### Detyra 4

(a) SNA 450 Vlerësimi i anomalive të identifikuara gjatë auditimit përshkruan përgjegjësitë e auditorit në vlerësimin e efektit të anomalive të identifikuara.

**Kërkohet:**

Përkufizoni 'anomalitë e pakorrigjuara' dhe shpjegoni përgjegjësitë e auditorit lidhur me anomalitë e pakorrigjuara. (5 pikë)

Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e Levreku Shpk. Aktiviteti kryesor i kompanisë është shitja me shumicë e peshkut të ngrirë. Pasqyrat financiare draft për vitin që përfundoi me 31 mars 2018 paraqesin të hyra prej €67.0 milion (2017 – €62.3 milion), fitimi para tatimit prej €11.9 million (2017 – €14.2 milion) dhe pasuri totale prej €48.0 milion (2017 – €36.4 milion).

Çështjet në vijim janë paraqitur gjatë auditimit dhe duhet të konsiderohen nga ju.

(a) Në fillim të viti 2018 një rrjedhje nga njësitë e ftohjes së kompanisë kishte shkaktuar kontaminimin e disa pronave. Levreku kishte shpenzuar €0.3 milion në kosto të pastrimit, €0.6 milion në modernizimin e njësisë për të parandaluar rrjedhjet në të ardhmen dhe kishte paguar €30,000 gjobë nga agjencia rregullatore. Përveç gjobës, e cila ishte paraqitur si shpenzim, kosto tjera janë kapitalizuar si përmirësime të pasurive. (7 pikë)

(b) Deri sa njësitë e ftohjes ishin duke u modernizuar, Levreku kishte nënkontraktuar ftohjen tek kompania Hog, ku i mbante produktet. Me 31 mars 2018 nuk ishte e mundur të inspektohen fizikisht stoqet e Levreku që mbaheshin nga Hog për shkak të kërkesave të shëndetit dhe sigurisë që ndalonin personat e paautorizuar të qaseshin në depo. Menaxhmenti i Levreku kishte ofruar një letër të përfaqësimit se stoqet që mbaheshin me 31 mars 2018 ishin €10.1 milion (2017 – €6.7 milion). Kjo shumë është përputhur me koston nga raportet mujore të mallrave nga Hog.

(7 pikë)

(c) Levreku posedon një apartament për banim mbi zyrat kryesore të tyre. Deri në dhjetor 2017 ky apartament ishte lëshuar me qira në vlere prej €3,000 në muaj. Nga janari i 2018 ky apartament ishte lëshuar një zyrtari e lart ekzekutiv të shitjes së kompanisë, pa qira. (6 pikë)

**Kërkohet:**

Gjatë rishikimit të letrave të punës së auditimit dhe pasqyrave financiare të Levreku për vitin që përfundoi me 31 mars 2018:

- (i) Komentoni mbi çështjet që duhet të konsideroni; dhe
- (ii) Tregoni çfarë dëshmi të auditimit pritni të gjeni lidhur me ato çështje.

**(Total = 25 pikë)**

## Zgjidhja

### a) Anomalia e pakorrigjuara

Një anomali e pakorrigjuar është anomali e akumuluar gjatë auditimit nga auditori i cili nuk është korrigjuar nga kompania.

Si pjesë e procedurave të përfundimit të auditimit, auditori duhet të konsideroj nëse totali anomalive të pakorrigjuara në pasqyrat financiare është materiale, pasi që është llogaritur dhe konfirmuar materialiteti. Gjatë përcaktimit nëse anomali të pakorrigjuara janë materiale (individualisht ose të grumbulluara), auditori duhet të konsiderojë madhësinë dhe natyrën e anomalive dhe efektin e tyre në pasqyrat financiare të periudhave të mëparshme.

Auditori duhet të kounikojë anomali të pakorrigjuara te personat e ngarkuar me qeverisjen. Auditori po ashtu duhet të kërkojë përfaqësime të shkruara nga menaxhmenti nëse ata besojnë se efekti i anomalive të pakorrigjuara është jomaterial.

(a) Rrjedhja kimike

(i) Çështjet për tu konsideruar

- Kosto e pastrimit prej €0.3m nuk duhej të ishte kapitalizuar por të shpenzohej. Kjo shumë përfaqëson 0.6% të pasurive totale dhe 2.5% të fitimit para tatimit prandaj nuk është material.
- Kosto e modernizimit prej €0.6m përfaqëson 1.2% të pasurive dhe 5% të fitimit para tatimit prandaj është material për pasqyrat. Kapitalizimi i I tyre do të ishte i saktë në pasjtueshmëri me SNK 16 nëse shpenzimi e përmirëson përfitimin ekonomik të pasurisë.
- Gjoha prej €30,000 nuk është material dhe është paraqitur si shpenzim në mënyrë të saktë.

(ii) Dëshmitë e auditimit

- Faturat e pastrimit dhe kostot e modernizimit
- Korrespondencat me agjencitë rregullatore ëpr të konfirmuar shumën e gjobës
- Ekstraktet bankare për të konfirmuar pagesat
- Procesverbalet e takimeve të bordit për diskutimet e rrjedhjes
- Inspektimi fizik i njërive ftohëse për të konfirmuar se kosto e modernizimit ka ndodhur

(b) Stoqet e mbajtura nga Hog

(i) Çështjet për tu konsideruar

- Stoqet janë material për pasqyrën e pozitës financiare, 21 % të pasurive prandaj auditori duhet të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për vlerën e tyre.
- Stoqet janë rritur nga viti i kaluar me 51 % që është shumë e madhe prandaj duhet të hetohet kjo rritje.
- Përfqësimi i shkruar nga menaxhmenti nuk është i mjaftueshëm prandaj duhet të kërkohen burime tjera të pavarura për të konfirmuar shumën prej €10.1 milion.
- Nëse shuma e stoqeve nuk mund të verifikohet mjaftueshëm, kjo paraqet kufizim të objektit të auditimit, prandaj nevojitet modifikimi i opinionit.
- Edhe pse sasia e stoqeve të mbajtura nga Hog mund të ofrohet, kjo nuk ofron dëshmi për vlerën e tyre në fund të vitit. Duke marrë parasysh se stoqet janë peshkë i ngrirë, mund të ndodhë se disa nga stoqet mund të jenë të dëmtuara ose të skaduara. Prandaj stoqet në fund të vitit mund të jenë të mbivlerësuar.

(ii) Dëshmitë e auditimit

- Përfaqësimet e shkruara nga menaxhmenti.
- Korrespondencat në mes të Hog dhe kompanisë për stoqet
- Listat mujore të sasive nga Hog
- Procedurat analitike siç janë krahasimet nga muaji në muaj të stoqeve dhe krahasimi me vitin e mëparshëm.

(c) Apartamenti

(i) *Çështjet për tu konsideruar*

- Personi i shitjes është palë e lidhur sipas SNK 24 pasi që ai është anëtarë i menaxhmentit kyç.
- Prandaj një transaksion në mes të palëve të lidhura ka ndodhur edhe pse nuk ka pasur këmbim të parasë
- SNK 24 kërkon që transaksionet me palët e lidhura të shpalosen në pasqyrat financiare pasi që janë material për nga natyra. Duhet të shpalosen emrat, marrëdhënia, shumat e përfshira dhe përshkrimi i transaksioneve. related parties, the relationships, the amounts involved and a description of the transactions.

(ii) *Dëshmitë e auditimit*

- Marrëveshja e qirasë për të konfirmuar shumën prej €3,000
- Fletëposedimet për të konfirmuar pronësinë e apartamentit nga kompania
- Inspektimi fizik i apartamentit
- Përfaqësimi i shkruar nga menaxhmenti për të konfirmuar palët e lidhura dhe për të konfirmuar se janë bërë shpalosjet e duhura në pasqyra
- Një përfaqësim i shkruar nga drejtori i shitje për të konfirmuar se është qiramarrës.